



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Prilijeno Më/Dana <u>17.07.2012</u>			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
<u>01-013/</u>	<u>863</u>		

Kuvendi i Komunës së Vitisë
Skupstina opština Vitina
Municipal Assambly Vitina

Në bazë të nenit 12.2 pika d) lidhur me nenin 10.2 pika c) të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika c) të Statutit të Komunës së Vitisë 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 13.07.2012 aprovon këtë:

V E N D I M
PËR RIALOKIMIN E MJETEVE KAPITALE BRENDA PROGRAMIT

Neni 1

Me këtë propozim vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë lejon rialokimin e mjeteve brenda programit – rialokimi i mjeteve për projekte kapitale gjegjësisht bartjen e mjeteve prej një projekti në projektin tjetër dhe atë:

Rialokimi i mjeteve të projekteve kapitale 2012

Fondi burimor 22

Programi Buxhet dhe Financa (175) nënprogrami (17533)

Nga projekti “ Rregullimi i murit mbrojtës të shkollës fillore Hasan Alija – Remnik” kodit (83377) në shumë prej 16.380,00€,

Në projektin: **Rregullimi i rrethojës dhe fushës së futbollit në shkollën fillore “ Hasan Alija” në Remnik në shumë prej 16.380,00€.**

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe nënshkrimin nga ana e Kryesuesit të Kuvendit.

Vendimi i dërgohet:

1. Ministrisë për Financa,
2. Drejtorisë për Financa,
3. Në dosje të Kuvendit
4. Arkivit

KRYESUSI KUVENDIT
Skenderbe Hebibi

